

VENDIM
Nr.24, datë 2.11.2009

PËR LICENCIMET E SUBJEKTEVE
SHA UJËSJELLËS, HAS DHE SHAUK, LIBRAZHD

Në mbështetje të nenit 14 pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.400, datë 19.8.1999 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë.....”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të licencojë subjektin sh.a. Ujësjellës, Has me:
 - Drejtues ligjor z. Sokol Peka
 - Drejtues teknik z. Hajredin Cahani.
- 1.1 Subjekti licencohet në kategoritë:
 - A/1 Prodhimi dhe grumbullimi i ujit për konsum publik.
 - B Shpërndarja e ujit për konsum publik.
- 1.2 Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare, deri më datë 1.11.2013.
2. Të aprovojë drejtuesin e ri teknik të sh.a. Ujësjellës-Kanalizime, Librazhd, znj. Xhekiola Marishta.
- 2.1 Licenca e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime, Librazhd me drejtuesin teknik të mësipërm është e vlefshme deri më datë 22.6.2011.

KRYETARI
Avni Dervishi